

BIBLIOTEKA

E

8JH-1
R79

LILLEHØS

GJIROKASTER

PETRAQ
RISTO

them
shekullit
mirëmëngjes!

POEMA
DHE VJERSHA

8SH-1
RYP

PETRAQ
RISTO



I them shekullit mirëmëngjes!

**poema
dhe vjersha**

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

P o e m a

no - bukuri, avullimët e lëkurës rëqës sës me
zësologjori la tash që e njevojsh, përdit illos së
avullimët është që shqetësia është tulli i vërtetë
shqetësia që zbulon rreth qëndrave qëndra
dhe qëndra e vërtetë është që pëllët shqetësia me
tash që shqetësia është vërtetë pëllët, qëndra e
vërtetë qëndra qëndra e vërtetë qëndra qëndra
I THEM SHEKULLIT MIREMËNGJES!

1.

Nën brinjët e paraleleve dhe meridianëve
rreh zemra e revolucionit!

Sa bukur!

Të jesh një çerek shekulli djalë
e të shkruash për shekullin,
e të shtrëngosh duart e tij të mëdha
nga puna e lufta e planetit,
e t'i thuash si gjyshit luftëtar:

— Mirëmëngjesi, shekull!

e ai të të përshëndesi:

— Djalo, mirëmëngjesi!

Kam ecur n  p  r rrug  t e fshatrave
 ku dielli t  rheq karroc  n e g  zuar t   m  ngjesit,
 kam bujtur n   sht  p  t   plot drit   t   fshatar  ve
 e bashk   kemi folur p  r buk  n, p  r shtetin.
 Kam njohur pleq t   men  ur
 dhe ulur rreth plisave t   sapo  car   nga plori,
 si rreth sofrave t   vogla avulluese,
 me k  ng   e me iso kam ngrohur kraharorin.

Kam qen   n   uzina, n   veprat e m  dha
 e duart me kallo kam rrokur,
 e me v  llan   u b  ra m   v  lla,
 e m   shok u b  ra me shokun.

Dhe i lumtur kam thirrur:
 Bujr  m, njer  z t   mir  
 t   tok  s sime lavdimadhe,
 bujr  m!

P  r ju — sof  r kam zemr  n,
 p  r ju — buk   e krip   i kam vargjet.

Bujr  m, njer  zit e mi,
 t   m  blidhemi rreth sofr  s
 me gjerdan  t n   brez,
 me arm  t n   supe,
 me barutin n   vezme
 e me hallet e bot  s!

T   m  bledhur rreth sofr  s,
 si n   legjenda popullore,
 ne brezat, shtrir  

nga koha e Gjergjit
te kuqëlimi i epokës,
ne — bukuria e kohëve.

Bujrëm, njerëzit e mi!
Ju duarreshkurit nga puna e baruti,
ju supegërryerit nga gjalmat e dyfeqeve,
ju — të paepurit,
ju — të palodhurit
që bëni ballin e shekuje!

3.

I them shekullit mirëmëngjes
e shpirti më çelet si lule me vesë,
e këngën këndoja me gjak e me besë:

Moj Parti me tetë kongrese,
tetë diej, tetë mëngjese,
zemrat-farka varg i ndeza,
ç'bukuri!

Moj Parti me tetë nure,
çan rrëthime, thyen mure,
me superfuqitë u zure,
ç'trimëri!

Moj Parti me tetë guxime,
bën bllokadat copë, thërrime,
rrit një popull mes stuhive,
s'trembesh ti!

Syri yt te thepi i pushkës,

zemra mbirë te komunizmi,
moj Partia ime e bukur,
binjake me heroizmin.

4.

Rritemi si ata lisat e rinj
që mbajnë mbi supe dëborë të rëndë
po që nga pesha e saj kurrsesi
nuk iu merren këmbët.
Ecim. Çajmë përmes rrithimit.
Buzët tona fishkëllejnë
meloditë e vdekjes së armiqve
dhe gjaku ynë i kuq
plot jetë rrjedh
në miliarda kapilare të agimeve.

Kërcasin dhëmbët teletajpet
plot kërcënime qeverirash:
«Shqipëria kokëfortë na qenka prapë,
e çuditshme kjo Shqipëria!».«
Dhe shumë gjëra thonë,
dhe shumë gjëra shpifin,
avazin e vjetër përsëritin gjithmonë
si në mitin e Sizifit.

Kërcasin dhëmbët teletajpet,
kreshpërohen leshrat e superfuqive
njëlloj si ujqërit para zjarreve

tremben nga Partia ime.

Miliona na shtrëngojnë duart,
armiqtë të habitur thonë:

«Po si xhanëm nuk u gjunjëzuan,
ku dreqin mushka i çon!»

Zotërinj,

gospodinë,

mësjetë,

xhentëlmenë,

nëpër shekuj për Shqipërinë
shumë nga ju kanë bërë benë.

Ja, si ju ishte Bismarku,

si ju ishte Çamberleni,

si ju ishte Hrushovi

e soj e sorollop qeni!

Po ne nuk u dhamë,

po ne nuk u tutëm

dhe botën e re

përmes yllit e pamë

dhe në orbitën e yllit

gjithë zemrat i futëm.

Popuj, vigjiloni,

popuj, mos harroni,

Imre Nagë tē rinj

mund tē rriten nga krimbat

dhe hrushovianët tē rilulëzojnë

në tē tjera ngjyra!

mbulojnë rrudhat dhe plagët
si me kozmetikë damat...
Po gjaku i qyteteve shpérthen

kryengritje.

Gjokse uzinash, grushte proletarësh,
gati për goditje, gati për zjarr.
Frym tufani,

fishkëllen pareshtur
si kryengritës i ndezur nga pasioni.
Revolucioni —

simfonia jote,
shekull.

Po vjen, po vjen, po vjen liria!
Vëlla brazilian, që godet mbi fashizmin,
jam me ty, pranë trimërisë sate;
jam me ty, vëlla arab dhe motër arabe,
jam me ty, vëlla irlandez dhe motër irlandeze;
jam me ju të gjithë:

të kuqtë,
trimat,
të paepurit!

Jam me ju
besnikët,
luftëtarët,
të patremburit!

Përpara, vëllezër, përpara!
Të pesë kontinentet,

si pesë shqisa janë:
shikojnë,
dëgjojnë,
prekin,
nuhasin,
shijojnë —
revolucionin!

7.

Mirëmëngjes!
Kështu i them shekullit
unë, shqiptari i palëkundur nga hallet,
që motra kam shqiponjat
dhe vëllezër malet.

Sa bukur!
Të jesh një çerek shekull djalë
e të shkruash për shekullin,
e të shtrëngosh duart e tij të mëdha
nga puna e lufta e planetit,
e t'i thuash si gjyshit luftëtar:

— Mirëmëngjesi, shekull!
e ai të të përshëndesi:
— Djalo, mirëmëngjesi!

KUJTOJMË DHE AKUZOJMË

(Mathauzen)

Në portën e ferrit

Ja Mathauzeni
si plagë e vjetër
që me një tel
akoma qëndron qepur.

Dhe Danubi
rrjedh e zien përbri
si Akeroni në ferr,
dhe oxhaku i lartë
i krematorit-lubi
dhe tmerr.

Ja Mathauzeni
dhe përmendoret e kombeve
përballë,
dhe gjaku,

gjaku i derdhur
më shumë se në legjenda
e përralla.

Ulërinte komandanti Franc,¹⁾
i tmerrshëm si qeni Cerber²⁾:

«Ju
që prej mishi
hytë në kamp,
krematori
si tym,
do t'ju nxjerrë!»...

Gurorja «Uener Graber»

Gurorja «Uener Graber»,
ti më pjellorja e botës
për gurë varresh!

Gurë. Gurë. Gurë.
Me to nazistët gdhendnin përmendore
në sheshet e Hamburgut e Berlinit;
me to nazistët ngrenë ndërtesa
mbi themele krimi.

Po ti mbahu, vëlla!
Liria fillon te fluturimi i zogut

dhe te fjala «qëndro»,
zbrit e ngjit «shkallët e vdekjes»
po për jetën lufto!

Mbahuni, vëllezër,
siç u mbajtëm në Çermenikë
mes acarit të dimrit,
siç u mbajtëm në Madrid
në rebelionin e egër,
siç u mbajtëm në Varshavë,
në Athinë, në Hamburg,
ku era e plumbit
flladiste flamur.

Liria fillon te fluturimi i zogut
dhe te fjala «qëndro!»,
ngjit e zbrit «shkallët e vdekjes»
po për jetën lufto!

Një vaj në Marbah

Këtu varroseshin të gjallët...
Dhe era frynte
dhe merrte hirin e vakët,
rendte me hirin e tyre...
Marbah, Marbah,
moj gropë e mbushur me kufoma,
moj gropë e mbushur «oh» e «ah»,

pse i kalbe èndrrat e njoma
e korbave u dhe gjah!

Hitleri qesh, ulerin, jargavitet,
të gjallët e ndershëm
vriten e vriten.

Këtu varroseshin të gjallët
dhe era frynte,
gufohej vela e resë,
oxhaku tym nxirrte
e dukej kampi si anije
me kafkë piraterie.

Marbah, Marbah,
sofër rrëthuar nga körba,
Himleri dhe Franci luajnë shah
me ushtarë të drunjtë?
Jo, me koka.

Endrra dhe grushte

Danubi rrjedh
dhe yjet si mollë të arta
na varen mbi supe,
pa shih.
Ej, Hoze, Kozma, Abraham,

do shkundim mollët
tani!

Dhe shokët heshtnin
si gropë e mbushur
me hi.

Do të shkundim mollët
e nënët do t'i mbledhin në futa,
oh, mollët — yje
larë me lotët
e nënave të urta!

Dhe shokët heshtnin
dhe lotët binin mbi grushta.

Ai shkonte drejt vdekjes
nën mollët e arta të jetës.
Në «shkëmbin e parashutistëve»
shqyhen së qeshuri esesët.

Oh, mollët — yje
larë me lotët e nënave të urta!
Heshtnin shokët
dhe lotët
digjinin
mbi grushta.

Esesët e shtynë.
Ai ra nga shkëmbi,

siç këputet
nga qielli një yll.

Lotët
digjnin
mbi grushta.

Cerberi dhe të tjerët

Franc Cerberi
me turi nga hëna,
e ftohtë si i vdekuri.
Pse leh?

Të shfaqet në èndrra Marbahu,
të shfaqen «shkallët e vdekjes»,
dhomat luksoze të gazit
dhe furrat e zjarrita të djegies.

Çfarë keni, zoti Franc,
pse ulërini,
pinjoll skizofrenie?

Qetësohuni,
dhëmbët e artë
të të vrarëve
vazhdo numëro
si tespie!

Numéro kamxhikët
dhe stolat «bok»,
numéro ulërimat
e njerëzve
dhe të vrarët
me «artin e vrasjes
pas kokës»!

A, dhe kështu
nuk qetësoheni?
Ndien hirin e nxehthë
si ngrihet,
hirin e trimave
të ngjashëm me yjet!

Hiri thërret,
hiri akuzon,
njerëzimi ngrihet!

Dhe «shkallët e vdekjes»
pa shih, po lëvizin
nën këmbët tuaja,
o farë e hitlerëve.
«Shkallët e vdekjes»
kërkokan nazistin.

Njerëzimi
do hakmerret!

Zogu i shpresës

Shpresa lind me diellin,
kur lulët çelin sytë
me lot vese.

Çohu, Kozma³, e dëgjo,
çohu, Telat⁴, e këndo
bashkë me një zog,
zog shprese.

Këndo, vëlla, vizato,
shkruaj kartolina
për të nesërmen;
o zog postier, fluturo,
u thuaj «ngjatjeta»
mëngjeseve!

Një zog i kuq me pendë agimi
ia thotë me këngë shprese.
Çohu, Enver⁵, e këndo,
çohu, Xhevdet⁶, e dëgjo!

Dëgjo dhe ti, vëlla,
nga Amerika e largët
dhe ti, spanjoll,
me shpirtin-pushkë dhe kitarë,
dhe ti, çek, ti, italian,
ti, austriak, e ti, polak,

ti, çifut-torturë e gjak...
dëgjoni, vëllezër,
me zemrat —
gjuhë të një flake:

Shpresa lind me diellin,
me diellin dhe me Stalinin.

Shpresoni, vëllezër!
Si buka na duhen
vizatimet tuaja,
si ajri na duhet
këngë,
si uji na duhen letrat,
kartolinat e urimit...

Në damarë injektojmë të ardhmen
dhe mposhtim injekzionet me benzinë.

Luftoni, vëllezër,
shpresa ndez damarët
si fitilat
dhe grusht dinamiti
shpërthen zemrën
mbi katilat.

Rezistenza

Kjo verë e vtit dyzet e tre
çeli filiza shprese,
ëndrra të shumta për botën e re
nga mbrëmjet në mëngjese.

Krematorët në qiel
firmosnin vdekjen,
komiteti i fshehtë
firmoste jetën.

Frika e Rajhut të Tretë
vraponte
nga kapot te esesët.

Mbi gropën e hirit
lindnin
feniksa të ndezur.

Endërro, vëlla,
një kopsht nën vesë,
dallëndyshet, foletë
dhe plori i mprehtë i hënës
si plisa i çan retë.

Në Rajhun e Tretë
një vlim tmerri,

në greminë të madhe
rrokullisej Hitleri.
Komiteti i fshehtë
firmoste jetën
dhe vdekjen për Cerberin...

Liri, välla,
motër, liri!
Dhe yjet si mollë të arta
na varen mbi supe,
pa shih!

Oh, mollët-yje
larë me lotët
e nënave të urta!
Kujtojmë shokët
dhe lotët
djegin mbi grushta.

Kujtojmë shokët,
Shqipërinë.
Ç'po veson një vesë malli,
ç'na njomë gjinë!

Kujtojmë dhe akuzojmë

Partizani ynë triumfator
me kondakun fortë godet nazistin.

Fluturojnë skifterët përmbi kremator,
skifterë të zinj
si parandjenja krimi.

...Kampin vizitojmë jo si turistë,
as si Virgjili me Aligerin...
Po ç'është ky përkrah nesh,
mos vallë neonazist,
mos vallë
vetë Franc Cerberi!

Se ja
te gurorja e tmerrshme diç kërciti,
dikush ulerin «shkallëve të vdekjes»
dhe te «shkëmbi i parashutistit»
ca yje ranë dhe prapë zunë të treten.

Dhe monumenti ynë lëvizi,
prapë partizani qëllon me kondak
dhe lulet sipër tokës valëvisin
petalet si flamurë ngjyer me gjak.

Pastaj një thirrje pushtoi kampin,
gjëmoi tej luginës së Danubit;
«Francëve të rinj
u ndalni hapin,
mos e lini pérroin
të fryjë lumin!»

Luftoni, vëllezër!
Liria ndez damarët
si fitilat
dhe grusht dinamiti
shpërthen zemrën.

Vjenë-Tiranë, vjeshtë 1980

-
- 1) Komandanti i kampit të Mathauzenit
 - 2) Cerber-qeni që ruan portën e Ferrit të «Komedia hyjnore» e Aligierit.
 - 3) 4) 5) 6) Kozma Nushi, Telat Noga, Enver Velja, Xhevdet Doda, janë disa nga të rënët shqiptarë në këtë kamp përqëndrimi.
 - 7) Një nga torturat e nazistëve.
 - 8) Komiteti i krijuar në kamp, që organizonte rezistençën e të burgosurve.

NË VENDLINDJEN E MARKSIT

(KARL MARKSIT NË 100-VJETORIN
E VDEKJES)

1.

U mek mëngjesi në Tririn¹⁾ e lashtë,
në Porta Nigra² u stepën turistët,
vizitorët që dolën nga kisha romake
harruan legjendën e veladonit të Krishtit.³⁾
Qyteti i Tririt me vreshtat në pjekje,
banorët, amfiteatri, makinat, anijet,
dëgjojnë një këngë si fitil në ndezje.

Njatjeta, Marks, gjeni i dheut!
Vijmë nga larg, prej Shqipërie,
zjarrin e kuq të Prometeut
e mbajmë në gjoks
e kthejmë në yje.

Dhe tokim duart me gjeniun
të kthjellët, si qiel mëngjesi
dhe kënga ndez historinë.

2.

Këtu ka lindur i madhi Karl Marks,
buzë lumit Mozel është rritur,
këtu është kthyer me zemër të vrarë
përballë vajzës së fikur.

Këtu janë pjekur frytet e para
që i vjel e ushqehet proletariati.

Këtu i është shfaqur

e kuqja —

fantazma,
që borgjezinë për fytë e kapi.

Te kjo shtëpi me lule mullage,
përballë vreshtave, ndanë një lumi,
i përkultur

mbi hartën

e botës së halleve

Marksi

projektonte

sulmin!

Dikur ca komunarë
pas shembjes me dhunë të Komunës
erdhën dhe në vise të Shqipërisë
si zogj krahëpërgjakur prej furtunës.

Dhe hynë në shtëpitë malësore,
hodhën vështrimin në muret e bardha,
panë ca pushkë të gjata, ca vegla muzikore,
ndien aromë baruti dhe brumi të ardhur
dhe besë kërkuan nga shqiptarët.

Bujrëm, në vendlindjen e besës!

Dhe u ndez biseda për Komunën e Parisit
njëllojë si për Krujën rrëthuar nga sultani,
malësorët me gjak prej baruti të shkrirë
dëgjonin bisedat e ndizeshin
e martinat e nxehta në mure
dufe betejash ofshanin.

Dhe folën për Parisin nën komunë,
për «Marsejezën» ndezur mbi Bastije,
për proletarët që vetëm me dhunë
këputën si «oh—!» pranga robërie.
Dhe folën për një Tier gjakatar
që vrau e preu si ujk i pabesë...
Ish natë dhe qelli i bukur shqiptar
ngjante si varrezë e Per Lazhesë.

Që atëherë, Marks, të njohëm ty
dhe zemrën ta vumë në histori.

4.

Kur Shlimani zbuloi Trojën
dhe ogurzezat gjurmë të kalit,
ti, Marks,
vëzhgoje ashpër kapitalin.
Arkeologu amator
s'e gjeti dot të drunjtin kalë,
vallë kish vrapuar nëpër botë
si një centaur-kanibal.

Bashkëkohësi yt gjente në Trojë
të artat xhevahire të Helenës.
Ti, Marks, shoqerinë gërmajo
dhe gjeje
xhevahiret e vjedhura
të mbivlerës.

Dhe kali i ikur nga Troja e lashtë
trokonte hidhur në kontinente,
mbi të kaléronte kapitali i dhjamur,
i dhjamur prej mbivlerave.
Vrapon ky kalë
në Beograd e Moskë,
në Budapest, Paris, Pekin...

Mbajeni frerët atij kali!
Komunizëm!

ngrihu
si betim!

5.

Si dielli që ngroh
e krijon erën
ti erën tonë krijove, Parti!
Frym kjo erë,
rrëzon,
përgjak të vjetrën
dhe piedestale ngrë histori.

6.

C'u kthye, Marks, kështu shtëpia jote,
në një podium këngësh për Partinë.
Mullagë e kuqe diçka po të thotë,
petale hedh mbi ty, krijon shaminë.
Të gjithë shamikuqtë, gjuhëza të një zjarri
këndoja e këndoja për PPSH-në.
E vjetra botë rënkon pa shpresë te varri,
mbi të varrmihësit grushtet kanë vënë!

Porsi shigjetëza me helm
mbi ty, Marks, hedhin anatema

po madhështor ngrihesh mbi dhe
si një furtunë me zgalema.
Dhe «zoti kapital» gëlltitet,
i merret fryma dita-ditës,
proletarët i faniten
si pushkatarë e si varrmihës.

Gérmo, varrmihës,
hape varrin,
me forcë po sjellim
një kufomë.

Një botë e re
po nGRE siparin —
bota Jonë!
Drang e drang çekanët mbi zinxhirë,
(dëgjoni ç'muzikë proletare!).
— Ngrihu, shok, vëlla,
sulmo qiejt! —
thërret trumpeta komunare.

7.

Të vënë, Marks, në sfonde presidiumesh
e në dritë të ballit tënd thurin intriga,
përpara teje përzjejnë zjarr opiumesh
si në një valle satanike shtrigash.
Dhe férkon duart «zoti kapital»,
fiton pak kohë, zgjat ditëvdekjen
dhe pjell i gjori «modernët» Lasalë:

«Popullore, popullore t'i bëjmë shtetet!...»
Ka parti të kthyer në yje të shuar
«Kapitali sot është moderuar...
Nga punëtori i Marksit
jetojmë dhjetë herë më mirë,
ndaj s'ka ç'na duhet diktatura,
s'na duhet çekani
për të thyer zinxhirë!...»
Jo parti,
po shelgj lotues, më mirë!

Drang e drang çekanët mbi zinxhirë
në Palestinë, Guatimalë, Salvador, Afganistan...
Drang çekanët
dhe shpirti nxjerr xixa
dhe xixa rritet
të krijojë fantazmën.
Daltë e Marksit gdhend e lëshon flakë.

8.

Ç'u kthye, Marks, kështu shtëpia jote
në një podium këngësh për Partinë.
Mullagë e kuqe diçka po të thotë,
petale hedh mbi ty, krijon shaminë.
Dhe bashkë me ne
këndon dhe ti, Karl Marks:
Komuna e Parisit
në Tiranë po jeton,

bota ka të tjerë komunarë,
fantazma e Manifestit
u bë revolucion
dhe flamur u bë
në truallin shqiptar.

Trir-Tiranë 1980-1982

1) Qyteti ku ka lindur Karl Marks

2) Porta e zezë-kështjellë e vjetër që nga koha e pushimit romak, Pikë e njohur turistike.

3) Sipas legjendës në këtë kishë ruhej veladoni i Krishtit. Për këtë u krijua një këngë satiriike, të cilën e këndonte me dëshirë edhe Marks.

TRENI I MESNATËS

B A D E N

Treni trokon në tokën e huaj,
jashtë bie shi.
Një djalë na afrohet, shtrin duart,
pak bukë lyp ky hipit.
Udhëtojmë me trenin e mesnatës
në këtë tokë të huaj me shi.
Nuk na flihet. Ia marrim këngës,
një këngë me Shqipëri.

Vjosa e poezisë 1980

B A D E N

Në këtë qetësi të shtrirë buzë liqeneve
mes bukurisë së ftohtë të peizazhit
ëndërronte dhe këndonte me zë mjellme
tretur nga sëmundja Naim Frashëri.

I thithnin mushkëritë ajër të pastër,
po prapë në të mungonte diçka.
Oksigjenin që s'mund ta gjente në ajër
krijonte në poemat e mëdha.

Vjenë, korrik 1980

ÇFARË THA ARBÈRESHI PLAK

Deti vjen
e deti shkon
gufuar nën hënë,
një pulëbardhë
po fluturon
porsi mall i nënës.

Ngjitu, bir,
vendos flamurin
në majë të pemës,
do fryjë erë
flamur-flugeri,
do tregojë Atdhenë!

POL ELUARI NË SHQIPËRI

PEVK

Ishte një qiel i kthjellët si shpirt poeti.
Era i binte flautit magjik
dhe lulet, gjethet, bari, èndrrat
kërcenin me gëzimin e diellit.
Kërcenin, sa bukur kërcenin!
Qenka bukur! Tha këto fjalë
dhe Gramozi hoqi një beretë prej bore
të nderojë poetin.
Ai ecte në një tokë të lirë, të qetë,
mes bukurisë së egër ku zogjtë
dhe pse të ngjashëm me zogjtë e Francës
dukeshin me krahë më të lehtë.
Ecte dhe mendonte se në këtë vend
ku kuvendorin mjegullat, rrufetë, shpatat dhe
gjakrat,
kishin ardhur tabore ushtrish
dhe ishin kthyer të mundur.
Kishin ardhur dhe poetë, Bajroni, për shembull
dhe kishin ngritur poema të mëdha.
Ishte një qiel i kthjellët si shpirt poeti.

GJIBRALTAR, VERË 1983

Sinjalet «sos» vrapojnë mbi kreshtat e dallgëve
arrijnë gjer te sytë e detarëve,
gjer te kufjet e radistëve.

Dhjetë peshkatarë të trembur hidhen në det
kapur fort në jelet e shpresave.
Po anijet e huaja

i thanë «sos-it»

të heshtësh!

dhe me dyllin moskokëçarës
mbyllën veshët!

«Vlora» ndërron kursin,
ndeuzur gjithë motorët,
detarët mbledhur bashkë

te bashi i merakut!

Dhjetë spanjollë shqiptojnë emrin «Vlora»
pas jelevë të bardha të shpresave kapur.
... Me shkëmbinjtë e zhveshuri plaku Gjibraltar
mbi papirusin e lashtë të dallgëve
rishkruan atë ligjin e vjetër detarës
sot mbajtur gjallë prej shqiptarëve.

PËR DETARIN QË RA NË KRYE TË DETYRËS

Një çast anija në Kanal të Suezit, si lëmshi i ngashërimit në grykë.¹⁾ Një çast u step tek vinte mëngjesi dhe mbi direkë pulëbardhat sikur u nxinë.

Heshtëm të gjithë.

... Ne s'të varrosim në shkretëtirat e kuqërremta, nën hije piramidash, palmash, kaktusesh; ne, vëlla, s'të hedhim në pafundësi dettrash se në tokën nënë dhe i vdekur na duhesh. Aparatet si sy të skuqur feksin, radiogramet më të shpejtë se vetëtimat të skuqur nga lotët shkojnë e vijnë. Në tokën nënë si trimat të presin se re në detyrë, shoku ynë.

Ndalim në Egjipt.
Një të huaji anija iu duk katafalk i paparë,
nënqeshi: «Përse s'e hidhkan në det?!
Si mund të ballsamoset vallë një detar,
ky nuk është as faraon e as mbret!...»

Zotëri,
leksione s'ju mbajmë,
se ç'është për ne njeriu, e dini!
Nënët tonë vdekjen me ligje e qajnë
dhe breshëri shtijnë armët në shenjë nderimi.

Një këngë partizane strallin e zemrave ka ndezur,
këndojmë për ty, shok i mirë,
e ty të ndiejmë brenda gjirit!

1978

1) Detari Thoma Kozho u nda nga gjini i ekupazhit të anijes «Tirana» gjatë rrugës së kthimit për në atdhe. Shokët e balsamoën që trupi t'i varrosej në tokën nënë.

Gjermania - e vërtetë dimri

NE KËTË LAGJE PUNETORE

Dikur fashistët hidhnin njerëzit nga dritaret
dhe nën asfaltin e rrugës janë varret...
Këtu vranë trembëdhjetë të rinj,
trembëdhjetë rrugica kërkojnë emrat e
dëshmorëve,
po veshin e shurdhët bën plaka borgjezi,
«ata vranë veten» thonë proceset gjyqësore.
Tani në këtë lagje
ballkoneve çelin mullaga të kuqe.
(Si ilaqe mbi plagë-ca gjethë mullage
dhe mbi të rënët — lule.)
Tani në këtë lagje mbrëmjeve vonë
dëgjojnë Radio-Tiranën në gjuhën gjermane
dhe trembëdhjetë rrugicat
nga një emër kërkojnë,
dhe trembëdhjetë plagë
nga një gjethë mullage.

KAMPI I PËRQENDRIMIT NOJENGAM

Lapidar i lartë
si një gisht gjigantakuze.

Një kopshtar na tha se këtu
dhe trëndafilat e bardhë
marrin ngjyrë të kuqe.

TATUAZHE

Një njeri me tatuazhe në gjoks,
me tatuazhe në krah,
me tatuazhe në shpinë
ecën para nesh i krekosur
sikur ka nën këmbë Gjermaninë.

Në tatuazhe-fytyra e Hitlerit
dhe kryqi i thyer nazist
dhe kafka-simboli i vdekjes
në trupin e tij të pistë.

Lakuriq si burrat në plazhe
por asnjë det nuk e lan.

NUREMBERG, gusht 1980

AKTAKUZË NË NU REMBERG

(Që nga Lufta e Dytë Botërore e deri në 1 janar 1980, nuk janë dënuar për krimet e tyre 77.602 kriminelë nazistë).

Nga shtypi

Nurembergu brenda mureve të lashta,
si një sallë gjyqi ku bërtasin gjykatësit.

Për një çast — heshtje,
lotë krokodilësh
dhe fjala «vdekje»
në qafë të Geringut.

Po vetëm një çast,
po vetëm një çast.
Vallë ku shëtisin
 kriminelët e luftës,
ku lozin kumar,
ku hedhin një vals?!

Miliona duar të përgjakura
ngrihen,
çajnë cipën e tokës
dhe ballin e krimeve.

Në sallën e gjyqit,
në Nuremberg,
dënohen komunistë
dhe falen kriminelë...

URREJTJA E FËMIJËVE

TINTI I M ALTAQINTAZI OUK

(Në takimin e 4-t ndërkombëtar të rinisë anti-imperialiste dhe antifashiste bashkë me prindërit e tyre erdhën dhe disa fëmijë)

Vizatojnë fëmijët. Nën gishtërinjtë e tyre avionët digjen, shkrumbohen si zogjtë nga rrufetë. Nën lapsat e tyre, si nën bajoneta, mbërthyer padrejtësitë e shekullit të njëzetë. Dhe kryqeprihës mbi tanke pushtues, dhe kryqeprihës mbi burgje dhe një glob i madh lulëzon në ajër si një gonxhe e kuqe.

Vizatojnë flamurë të kuq kryengritës, kryqe mbi bomba, mbi Hitlerin-kryqe dhe duken ata seriozë e të rritur, si prokurorët e ndershëm në gjyqe. Vizatojnë fëmijët dhe pyjet e Thiergartenit, papritmas pemët i kthyen në lapsa... Fëmijët nga kombe të ndryshme të botës vizatojnë të ardhshmen sipas fjalëve të Marksit.

KJO KATEDRALJA E KËLNU

Kjo katedralja e Këlnit,
thonë, më e madhja në botë.

Sfungjer i kobshëm i dheut
sa lot ke thithur, sa lot.
Nëntë shufra floriri në gjoks —
dekoratë e egër shfrytëzimi.

Nëntë kambana bërtasin me forcë
me gjuhën e nënshtimit.

Ndaj dalim me vrap nga kjo kishë,
dalim, po ku të shkojmë?

Muzika kishtare si bishë
në rrugë, si nën kube, njëloj.

Në sheshin e madh të kishës

shtrirë një djalë narkoman
me krahët e hapur si Krisht,

vallë ç'kryq i padukshëm e mban?

Gjashtëqind vjet katedralja
punuar me daltë e çekanë...

Më shumë lot se qirinj
ka pikuar dhembja gjermane.

B O N

DITËN SË TË DHEMVE

C'qytet i ftohtë, etchedhënës
nën qiellin e zi e shirënës!

Shi mbi Bundestag,
mbi kancelari,
mbi gjimnazin «Bethoven» —
shi.

Dhe ca zogj të zinj
se nga dolën «krrak-krrak»
mbi kancelari,
mbi Bundestag.

Peshon globi nga revolta

DHEMBJA E LENINIT

Rrudhosur,
ngrysur
fytyra
e Leninit

atje
në mauzoleun
e ftohtë
si hidhërimi.

Kjo rrudhosje
nuk vjen
nga prishja
e balsamimit.
...Dhe i vdekur
dhembje
ndien
Lenini.

TË URITURIT E BOTËS

TRIJOM

(Balladine (muzika e kësaj i përmendur))

Të uriturit e botës: minatorët supevrarë,
fëmijë të pashkollë, nëna ushtarësh,
të burgosur të panjollë, vajza me barrë,
muzikantë ëndërrimtarë...

të uriturit e botës.

Të uriturit e botës ka kohë që bëjnë greva.
Ata kërkojnë më shumë se bukë,
ndaj luftojnë nga e hëna tek e diela
se dhe buka rri fshehur në çarkun e pushkës!

MOLLET

(Monolog i një të burgosuri antifashist)

Pakoja me adresën që nëna ka shkruar me mundim
dhe nën shkrimin e përlotur të saj
kuqojnë ca mollë të mëdha, të bucura si yjet në
maj.

Mollë të burgosura, të prangosura si unë,
më të pafajshme se foshnjet në gjumë.
Ju kontrolluan policët
se mos në mishin tuaj të ëmbël,
të ëmbël si fshati ynë,
shokët kanë fshehur një betim
apo një ndihmë të vogël sa një limë xhepi,
a një biçak sa një gisht unaze...
Me kujdes kontrolluan policët.
Po asgjë.

Vec dhjetë kokrra mollë
 të kuqe flakë
që kokë më kokë
 të gjitha bashkë
formonin
 fushën e flamurit të lirisë.

...
...
...
BALADA E GAMINAVE TË KOLUMBISË

Kjo hënë e zbehtë e Kolumbisë
sot qenka ngrirë si foshnj' e vdekur.
Poshtë në rrugë, mes natës pis,
mbështjellë gaminat¹ me gazeta.

Fëmijët poshtë. Gazetat sipër
si vela dridhen nga frymë-bunaca.
Kjo rrugë-anije e çuditshme,
thyer timoni, humbur spiranca.

Fëmijët flenë. Kurse gazetat
me njëra-tjetrën diçka flasin.
Demokraci shkruar në letrat
që sot zëvendësojnë çarçafët.

1) Gamina në Kolumbi u thonë fëmijëve që robtohen
në punë nga kapitalistët

Dhe mesi i natës nis gulçon
nga «ohe» dhembjesh fëmijnore.
Mbi këtë rrugë sot peshon
revolta e ardhshme punëtore.

Dhe erdh' mëngjesi sërish i zymtë,
si «oh» i ngrirë kjo hënëzbehta.
Ngrihen gaminat, fërkojnë sytë
dhe ndezin zjarre me gazeta.

Demokracia me tituj ari
në zjarr mëngjesesh bëhet shkrumb.
Skllevërit e mitur rrëzë trotuarit
grushtshtrënguar nisen në punë.

TË PASTREHËT E ROMËS

Pesë frysë — një familje
pa dysheme e pa tavan,
veç lulet çelur në lulishtë
porsi vajtojca u rrinë pranë.

Nuk ka shtëpi, s'ka as oxhak
si oxhak babai thith një llullë,
në vend të zjarreve si flakë
janë trëndafilat e sëmurë.

Po gjella s'bëhet përmbi llullë,
me trëndafila s'ngrohet gjiri.
Pesë gishtérinjtë bëhen grusht,
ëndërrojnë ditët që do vijnë.

Dhe lulet vetë mbledhur gonxhe —
grushte të ndershme të tokës
si dëshmitare akuzuese
për të pastrehët e Romës.

TE ISHULLI I MARGARITËS

Ishulli i Margaritës

si një zonjushe

në prehrin e Danubit.

Shatervane që duan

të ngrihen drejt qiellit,

po thyhen

dhe kthehen

në lot turpi.

Këtu në stola

mës gjelberimit të pemëve

disa vagabondë

rrahën një femër.

Moskokëçarës

Danubi rrjedh

me Margaritën në prehër.

Budapest, korrik 1980

KËNGA E NJË VAJZE KILIANE

Jam në qeli me një të vdekur,
për tmerr e frikë ma sollën mbrëmë,
por unë s'kam frikë, nuk rri e heshtur,
në buzë, si lule vë një këngë.

Këndoja me zë përballë kufomës
«një zog mban iso tej qelisë,
një fllad përkul biskun e njomë,
një nënë ushqen foshnjën me sisë».

Këndoja dhe s'trëmbem nga i vdekuri
dhe kënga jetës i jep sisë.
Unë jam e fortë, një vajzë prej hekuri
që thyej muret e qelisë.

ANA NËN RRROTAT E TRENIT

Jo, nuk është Ana Karenina
që hidhet sonte në tren
dhe ky tren nuk është i zakonshëm
për rrota ka dollarët, rublat, jenët.
Jo, nuk është Ana Karenina
që hidhet sonte në tren,
një Anë tjetër hidhëruar ngajeta
vdekja sot e rrëmben.
Një Anë tjetër me tre fëmijë,
të tre pa ngrënë, të tre pavesur,
Po çfarë t'u bënte nëna jetimëve,
kur përveç krahëve s'kishte gjë tjetër?
Padroni i fabrikës në rrugë e hodhi
«je nënë, më mirë rrit fëmijë»,
njelloj si hajduti që kuletën vodhi
dhe i tha të vjedhurit: «ushqehu tanë»...
Kalon ky tren stacione e shtete
me rrotat e tij të ngjyera me gjak,

trak-truk ritmi i tij
si thyerje e eshtrave.

Eshtra Anash, Fredësh. Truk-trak.

Gulçon ky tren, gulçon pareshtur,
si një xhelat që vret e pret pa masë.
Jetimët qajnë mbi nënën e vdekur.

(Oh, çdo lot fëmije të ndershmin mund ta
vrasë.)

Dikur mbi roman, kur u vra Karenina,
Tolstoj «s'kisha faj», tha duke qarë,
po për Anat e reja që vriten,
kush është fajtor, kush i ka vrarë?

anës sëllorë ngrënës
entë pës teqiq i qollës

Gratës Fazilë
fishe e qytetarë
mësuarët është
tekuqet e mësuarë

omësiaq fëmijëve
Buzës me përgjegjës
mësuarët është
tëkuqet e mësuarë

SAVAT sello
është e idomës

IRAN 1979

Shpërthen revolta iraniane
njëlloj si puset arteziane.

Grushte. Parulla.
Rrugë të përgjakura.
«Personalitete» të strukura
si mace të rrahura.

Nga grushtet proletare
rrëzohen ushtarët,
njëlloj si të mundurit
në skakierën e shahut.

Policia SAVAK,
gjëmbi me rrënje amerike,

kérkon t'i pérçajë sadopak,
të hedh farën e frikës.

Por prapë grushte, thirrje,
këngë dhe zjarr.

Si mbreti i bërë mat në skakierë
ka mbetur shahu këtë herë.

GRANADËS NË TETORIN E PUSHIMIT

Granadë —
ishull i vogël
sa një mollëz gishti,
sa një teh thike;
t'u derdhën një ditë
ca djaj prej amerike.
Ishull i vogël —
kopsë në jelekun blu të Karaiive.

Të pushtuan një ditë.
Shkopsitën jelekun
e të gjakosën në shpirt
marinsat e hekurt.
Granadë —
ishull i vogël
sa një bletë.

Të pushtuan
po në vend të hirit
gjetën prush
dhe kuptuan
se më shumë se ishull
ti ishe
grusht.

— V. Sh. 29. — T. 19. — N. 10. — M. 19. — S. 19. —
G. 19. — L. 19. — M. 19. — S. 19. —

ORA MBRETËRORE

(Në pallatin veror të Maria Terezës, në Vjenë, ndodhet një orë e madhe horizontale)

Orë horizontale?!
Natyrisht kuriozitet,
Po vallë
kështu e bënë mjeshtrit
apo u shtyp
nga dhembja
e kohës së vet!

TE KËSHTJELLA E PESHKATARIT

Kështjelia e Peshkatarit — e bukur sa s'ka.
Këtu xhirojnë filma regjisoriët,
vërtiten turistët e bëjnë shaka,
shohin Budapestin në pëllëmbë, të dorës.

Përballë kështjellës — hoteli modern
me xhamia zaju ngjyrë kafe e errët.
Këtu pasqyrohet kështjella e lashtë
si në syzet e bosit,
një relikte e vjetër,
Në hotel — presidentë, sheikë, pashallarë
dhe intriga si në veprat e Shekspirit.

Mbi Danub
nuk hedh më grepa
Peshkatari,
mbi Danub
hedh grepat
Perëndimi.

NJË NËNË INDONEZIANE NË TREGUN E FOSHNEVE

Një nënë në tregun e foshnjeve,
dy fëmijë në krahët e saj,
si në krahë të një peshoreje.

Dy fëmijë — një mjerim
kanë në sy Indonezinë.

Dy fëmijë të lehtë pupël,
dy fëmijë të rëndë sa bota
i shiti për njëzet mijë rupi...

Në krahët bosh sa peshon revolta?

PARA PUSHKATIMIT

Një militanti veriirlandez

As vetë s'e di sa shpejt që u thinj nata
e u bë mëngjes.

Lotët e mi u ftohën në pranga
e u kthyen në vesë.

Dhe zogjtë erdhën me pafajësinë e tyre
e më pyetën: — Si je? —

* dhe unë pa u dhënë shumë shpjegime
shkurt u thashë — Si dje.

Pastaj te porta erdhi gardiani,
që në vend të gjymtyrëve kish çelësa,
erdhi dhe një prift me erë temjani
(në njërin sy-ferri e në tjetrin-parajsa).

Unë qesha.
dhe gjymtyrët-çelësa mbetën të ngrira,
kurse prifti u nxi e unë s'kuptova
cili sy ish ferr e cili sy-parajsë!

E shoh në sy mëngjesin e thinjur
dhe ai më sheh në sy
dhe atje lexon telegramin tim për njeriun:
Të vdesësh për liri!

LIBRARY OF THE UNIVERSITY OF TORONTO

istat friti u ëp rreth zotit e sëmërrimit
që dëgjohet si një përgjigje
sëpse këtia është një përgjigje
sëpse këtia është një përgjigje

zotit e sëmërrimit që dëgjohet që
— këtia — tashmë që është
zotit e sëmërrimit që dëgjohet që është
zotit e sëmërrimit që dëgjohet që

zotit e sëmërrimit që dëgjohet që
zotit e sëmërrimit që dëgjohet që
zotit e sëmërrimit që dëgjohet që
zotit e sëmërrimit që dëgjohet që

BALADA E DY DEKORATAVE

Një nënë mori dekoratën e djalit
nga duart e kolonelit thinjosh,
në jastëkun-fytyrë, dekorata si gojë
me mburrje diçka zu t'i thosh:
«Nënë sovjetike, ty djalin ta vranë,
jam zemra e tij, jam shenjë lavdie,
vij që larg, nga toka afgane,
si vulë superfuqie...»

Lotët prej nëne kush vallë ia shteri,
pse u hutua dhe mbeti si qyqe.
Jastëku i kuq u nxi si nga tmerri,
siç nxihet flamuri kur digjet.
Dhe nëna e gjorë me jastëkun në duar
me dhimbje kujtoi fëmijërinë e djalit,
atëherë kur ëmbël këndonte ninulla
me erën e stepës e zërin e malit...
Hapi sirtarin në një komodinë
dhe nxori një shall me yje të arta,
ngadalë, duke qarë e zgjidhi shaminë

dhe vuri në jastëk një tjetër dekoratë.
Dhe mbetën të dyja dekoratat përballë,
siç rrinë në një stepë dy vetë pér duel,
e vjetra skuqte si plagë e gjallë,
e reja nxinte si ferr.

Përkëdheli ngadalë dekoratën e vjetër
të burrit të vrarë në luftë me gjermanë:
«E rrita djalin, u bë oficer,
dhe në tokat afgane si pushtues e vranë...»
Një «oh» lëshoi dekorata e vjetër
si klithma e të vrarit në duel.
Mbi jastëkun e shtrirë si mbi një stepë,
një plakë e vetmuar kujës ia merr.

Dpa uan Cjekoslovakja
das Burgenland als Teil
der Tschechoslowakei ist
seit dem 1. Januar 1920 ein
Teil des neuen Staates der
Tschechoslowakei.

KËNGA E EMIGRANTIT NË BASHKIMIN SOVJETIK

Shikojmë të gjithë kokën e hënës
si ajo-ne e thinjur prej mërzisë
larg shtëpisë, larg nënës
në pyjet thellë të Siberisë.
Disa vijnë nga Gjermania
dhe nga Ballkani vijnë të tjerët.
Thith emigrantët Siberia,
siç thith lëngjet një sfungjer.
Jo, s'më harrohet, dhjetë shokë
na i mori vdekja nën një trung
dhe unë e lava, oh, me lot
dorën prerë cung.
S'më bën përshtypje balalajka,
muzikë e zogjve në agim,
më duken drurët si plaka
që qajnë mbi qivurin tim.
Mbledh emigrantët Siberia
siç mblidhet magma në krater.

Disa nga Çekoslovakia,
nga Bullgaria vijnë të tjerë.
Shkruaj gjatë letrën me halle,
letrën-revoltë të pafund.
Ndër stepa era që hedh valle,
zemërimi ynë që pemët shkund!

anija-kishë i një qytetit
që nuk ka qytetin e tij

Anija-kishë i ri që nuk ka qytetit
që nuk ka qytetin e tij

ANIJA-KISHË

Anija-kishë gdhendur prej arre
kërcen mbi dallgë si shpirt i lig
dhe duket si grua me barrë
që rend të pjellë në një çiflig.

Rend të pjellë në dhjetëra porte
anija plot me priftërinj.
Ç'pako të zeza-mall eksporti
nëpër kabina ulërijnë!

Sipër direkëve ka kryqe,
anija duket si varrezë,
psallmet e zinj të priftërinjeve
e nxijnë më shumë natën e zezë.

Një prift i ri përmbi organo
muzikë tuist lot me pasion,

priftérinjtë e tjerë-orangotango,
ethja e muzikës i pushton.

Këndon kori i priftérinjve
dhe shuhën zërat nëpër natë,
«O zot, mbi botë shtoji kryqet,
anija jonë si një kryqëzatë!».

Në port të huaj plot gjëmim
ushtojnë thirrjet proletare.
Bëjnë kryqe, tremben priftérinjtë
njëllojë si minjtë nëpër hambare.

Dhe rrugën prapë anija merr
porsi një bishë e plagosur.
Nga Akeroni për në ferr
një rrugë e gjatë dhe e pasosur.

VIZATO BARRIKADËN

(Popujve që luftojnë kundër kapitalizmit)

Që të krijosh një barrikadë
mjaftojnë ca thasë me rërë, një qerre e përbysur,
pastaj një vrull me këngë dhe një flamur i
ngritur;
pas flamurit — qindra njerëz me zjarre në damarë
dhe qindra pushkë që hedhin gëzhojat si farë;
pastaj vjen një fëmijë, çapkën kaçurrelashprishur
që me gëzhojë në buzë vrapon e bën muzikë.
Veç mos harro burrin me ballin e përgjakur
dhe shallin e një gruaje si fasho mbi një plagë
dhe lulet që pikojnë të freskëta nga ballkoni
dhe fjala peshëmalore

— Qëndroni!

PËRMBAJTJA

Faqe

POEMA — I them shekullit mirëmëngjes!	3
Kujtojmë dhe akuzojmë	12
Në vendlindjen e Marksit	25
PRUSH MALLI — Treni i mesnatës	33
Baden	34
Çfarë tha arbëreshi plak	35
Pol Eluari në Shqipëri	36
Gjibraltar, verë 1983	37
Për detarin që ra në krye të detyrës	38
GJERMANIA-E VËRTETË DIMRI — Në këtë lagje punëtore	40
Kampi i përqendrimit Nojengam	41
Tatuazhet	42
Aktakuzë në Nuremberg	43
Urrejtja e fëmijëve	45
Kjo katedralja e Këlnit	46
Bon	47
PESHON GLOBI NGA REVOLTA — Dhembja e Leninit	48
Të uriturit e botës	49

	faqe
Mollët	50
Balada e gaminave të Kolumbisë	51
Të pastrehët e Romës	53
Te ishulli i Margaritës	54
Kënga e një vajze kiliiane	55
Ana nën rrrotat e trenit	56
Iran 1979	58
Granadës në tectorin e pushtimit	60
Ora mbretërore	62
Te kështjella e Peshkatarit	63
Një nënë indoneziane në tregun e foshnjeve	64
Para pushkatimit	65
Balada e dy dekoratave	67
Kënga e emigrantit në Bashkimin Sovjetik	69
Anija-kishë	71
Vizato barrikadën	73

DOK. 87

(L.M.B.)

1-680-188 (L.M.B.)

-87-



BIBLIOTEKA NATIONALE D'ALBANIA - TIRANA - 7401 TIRANA

Risto, P.

I them shekullit mirëmëngjes! Poe-
ma dhe vjersha. [Red.: P. Jorgoni]. T.,
«Naim Frashëri», 1984.

76 faqe

(B,m,) dhe
(B,v,): 891-983-1

R 79



Tirazhi 2000 kopje Formati 78x100/32 Stash: 2204-79
KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1984